

Kërkesat e hyrjes për Covid-19

- për nënshtetas të vendeve të treta pa banim apo qëndrim të përkohshëm në Austri,
- nënshtetas të vendeve të treta pa leje qëndrimi në Austri, pa të drejtë qëndrimi sipas NAG ose AsylG 2005, viza D ose letërnjoftim sipas § 95 FPG

nënshtetasit e vendeve të treta nuk lejohen të hyjnë në Austri.

Por ka disa përjashtime në këtë ndalesë të përgjithshme të hyrjes.

1. Përjashtim: Hyrja nga vendet e BE-së dhe Shengen

Nënshtetasve të vendeve të treta u lejohet hyrja **me certifikatë shëndetësore nga shtetet e mëposhtme:**

Andorrë, Belgjikë, Bullgari, Danimarkë, Gjermani, Estoni, Finlandë, Francë, Greqi, Irlandë, Islandë, Itali, Kroaci, Letoni, Lihtenshtajn, Lituani, Luksemburg, Maltë, Monako, Holandë, Norvegji, Poloni, Portugali, Rumani, San-Marino, Suedi, Zvicër, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Çeki, Hungari, Vatikan, Mbretëri e Bashkuar dhe Qipro.

Parakusht për hyrjen e nënshtetasve të vendeve të treta nga vende të BE-së dhe Shengen

- Personi paraqet një certifikatë mjekësore në hyrje, e cila konfirmon **testin negativ PCR** (Me rëndësi: Konfirmimi nuk duhet të jetë më i vjetër se 72 orë).
- **Gjithashtu** personi duhet të japë konfirmim të akomodimit (dhe t'i përballojë vetë shpenzimet)
- **dhe** pas hyrjes të kalojë 10 ditë në karantinë (shtëpie). Karantina **nuk mund të mbyllet para kohe** edhe sikur të jetë paraqitur test negativ PCR gjatë procesit.

2. Përjashtim: Hyrja për profesione të posaçme

Ka një përjashtim për nënshtetasit e vendeve të treta të grupeve të mëposhtme profesionale:

- diplomatë,
- punonjës të organizatave ndërkombëtare,

- punonjës të ndihmave humanitare,
- personel infermier dhe shëndetësor,
- punonjës sezonalë në bujqësi dhe pylltari,
- punonjës sezonalë në turizëm etj.

Parakusht për hyrjen e grupeve të posaçme profesionale

- Personi paraqet një certifikatë mjekësore në hyrje, e cila konfirmon **testin negativ PCR** (Me rëndësi: Konfirmimi nuk duhet të jetë më i vjetër se 72 orë).
- Gjithashtu personi duhet të kalojë **10 ditë në karantinë (shtëpie)** pas hyrjes. Karantina mund të përmbillet nëse testi PCR i kryer gjatë procesit del negativ.

3. Përrjashtim: Hyrja në kuadër transporti tregtar

Personat, që **udhëtojnë në kuadër transporti tregtar**, mund të hyjnë **me një certifikatë mjekësore**.

Kushti është që personi paraqet në hyrje një certifikatë mjekësore që konfirmon një **test negativ PCR** (Me rëndësi: Konfirmimi nuk duhet të jetë më i vjetër se 72 orë). Karantina nuk është e nevojshme në këtë rast.